



Udhëzues për prindër

„Fuqia e prindërve“

Shkup, 2016

ISBN 978-608-4603-07-8

Titulli: Udhëzues për prindër „Fuqia e prindërve“

Botues: Ambasada e parë e fëmijëve në Botë Megjashi- Republika e Maqedonisë

Drejtor ekzekutiv dhe themelues : m-r Dragi Zmijanac

Redaktore: Jana Zengovska

Lektura: Armend Nuhiu

Recenzues: doc. d-r Sasho Koçankovski

Përpunimi grafik dhe shtypja: „Bato dhe divajn“

Përkthimi në shqip : Armend Nuhiu

Adresa e botuesit:

Ambasada e parë e fëmijëve në Botë Megjashi- Republika e Maqedonisë

Rr. Kosta Novakoviç nr.22a, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Tel/faks +389 2 2465 316

E-mail: info@childrensembassy.org.mk

www.childrensembassy.org.mk

PËRMBAJTJE:

Parathënie.....	4
Hyrje	5
1. Moskujdesi ndaj fëmijës dhe dhuna psikologjike si formë e keqpërdorimit të fëmijëve	8
1.1 Mospërfillje	8
1.1.1 Çfarë paraqet mospërfillja si formë e keqpërdorimit të fëmijëve?	8
1.1.2 Format e mospërfilljes	9
1.1.4 Shenjat fizike të cilat na shfaqen tek fëmijët e mospërfillur	14
1.2 Dhuna emocionale mbi fëmijët	15
2. Stilet prindërore	17
3. Dënimi dhe shpërblimi gjatë procesit edukativ	22
Çka është loja dhe si të luhet?	26
Veprimet e prindit të përgjegjshëm në edukim	28
Përfundim	30
7. Literatura.....	32

Parathënie

Publikim jashtëzakonisht i rëndësishëm, e cila në një gjuhë të lehtë dhe të kuptueshme flet për ndëshkimin trupor, keqtrajtimin e fëmijëve, për rëndësinë e prindërisë së përgjegjshme në edukimin dhe në përgjithësi në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

Ky publikim ka për qëllim që ta përmbushë hapësirën në edukimin dhe përgatitjen e vetëdijes për këto dukuri të padëshirueshme, të cilët janë në rritje te fëmijët në Republikën e Maqedonisë. Është e dedikuar në rradhë të parë për fëmijët, prindërit, arsimtarët, mësimdhënësit dhe edukatorët e institucioneve publike dhe private të cilët punojnë me fëmijët, por edhe për të gjithë ata që janë të përfshirë në arsimimin joformal.

Këtë udhërrëfyes mund t`a shfrytëzojnë edhe anëtarët e shërbimeve profesionale të këtyre institucioneve arsimoro-edukative, qendrat për punë sociale, policia, shëndetësia...

Nga ky udhërrëfyes dobi edhe më të madhe do të kenë fëmijët, prindërit, mësimdhënësit, psikologët, pedagogët, punëtorët socialë dhe mjekët, të cilët pas dyshimit ose identifikimit të keqpërdorimit ndaj fëmijës, tregojnë për obligimin e tyre që të ndër marrin masa adekuate për denoncimin e tyre në institucionet kompetente /SOS qendrat, me qëllim të mbojtjes nga keqtrajtuesit.

Poashtu mund të shfrytëzohet edhe për qëllime arsimore në institucionet edukative-arsimore në mësimin joformal.

Informatat e shumta të cilat janë ofruar për ndikimin negativ të dhunës në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, si dhe mënyrat dhe format e edukimit, do t`u ndihmojë prindërve që ta ndryshojnë dhe

përmirësojnë sjelljen e tyre, jo vetëm ndaj fëmijëve të tyre por edhe ndaj fëmijëve në përgjithësi.

Sepse qëllimi i prindërisë nuk është vetëm mbrojtja e fëmijëve, por edhe krijimi i ambientit për zhvillimin e tyre të plotë, ku do të mund që ti realizojnë potencialet e tyre në gëzim, dashuri, mirëkuptim, respektim dhe mbështetje.

Me kënaqësi e rekomandoj këtë udhërrëfyes.

13.06.2016

Manastir

Doc. D-r Sasho Koçankovski

Doktor i shkencave psikologjike
dhe terapeut i Geshtalt-it

Hyrje

Të qenit prind është një detyrë me përgjegjësi shumë të madhe që ndonjëherë e keni patur.

Prind bëhemi në çastin kur do të lind fëmija jonë, nuk kemi mundësi që të stërvisim veten për rolin e prindërit, ose nuk na e kanë dhënë atë mundësi. Prandaj fëmijët i edukojmë ashtu siç mendojmë se është më së miri.

Fëmijët tanë kanë nevojë për ne të rriturit, që t'ju dhurojmë dashuri dhe kujdes dhe në një mënyrë të këtyllë ti mësojmë të duan edhe veten e tyre. Njëkohësisht, fëmijëve tanë ju dëshirojmë të gjithë të mirat, dëshirojmë që ata të jenë të suksesshëm, të lumtur. Ndonjëherë gjendemi në një situatë që nuk e dimë se si duhet vepruar në mënyrën më të duhur, që ti mos i përsërisim gabimet e prindërve tanë dhe t'ju përgjigjemi kërkesave të fëmijëve tanë. Jo rrallë herë kemi mundësi, forcë dhe fuqi që ti arrijmë të gjitha ato kërkesa të cilat i ka ndaj nesh mjedisi social. Shpesh mund të kemi ndjenjë se nuk jemi aq të mirë për të qenë prindër.

Gjatë edukimit duhet ti kemi ndërmend disa gjëra të cilat janë të rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës dhe raportin tonë me fëmijët tanë mbi atë se është përgjegjësi e jona se çfarë të rriturish do të krijojnë prej tyre.

Ky udhëzues i shkurtër është dedikuar që të na ofrojë informata themelore se çfarë në të vërtetë paraqet të qenit prindë i përgjegjshëm dhe si t'ju përgjigjemi sfidave të cilat i bartë e njëjta.

1. Moskujdesi ndaj fëmijës dhe dhuna psikologjike si formë e keqpërdorimit të fëmijëve

1.1 Mospërfillje

1.1.1 Çfarë paraqet mospërfillja si formë e keqpërdorimit të fëmijëve?

Mospërfillja paraqet formë e injorimit ose mosplotësimit të nevojave të fëmijës të cilat dukshëm ndikojnë mbi zhvillimin e tij psiko-fizik. Sipas disa definicioneve, jo rrallë herë fëmija me qëllim mospërfillet dhe kufiri ku fillon mospërfillja nuk është gjithnjë e qartë.

Fëmijët e mospërfillur nuk u jepet vëmendje, ata janë fëmijë të cilët në të vërtetë edhe nuk ekzistojnë në sytë e prindërve të tyre, prandaj këta fëmijë gjithë energjinë psiqike e shpenzojnë me qëllim që të tua tërheqin vëmendjen prindërve të tyre. Prindërit e këtyre fëmijëve nuk ju dërgojnë mesazh se janë të veçantë, të mirë, të bukur, të mençur.....këta fëmijë nuk e dinë se atë që veprojnë është në rregull apo jo.

Kur bëhet fjalë për vlerësimin mbi atë se a ekziston mospërfillje ndaj fëmijës, me rëndësi është që të definohen nevojat e fëmijës të cilat duhet të kënaqen me qëllim që të sigurojë rritje dhe zhvillim normal të fëmijës.

Nevojat themelore jetësore të fëmijës janë:

- Ushqim i duhur
- Mbështetje emocionale
- Higjiena personale
- Mbrojtja shëndetësore
- Kujdes për shëndetin mental
- Stimulim konjitiv

- Mjedis dhe strukturë familjare
- Mbrojtja nga rreziqet në shtëpi
- Mbrojtje nga dhuna në familje
- Mbrojtje nga dhuna në mjedise sociale

1.1.2 Format e mospërfilljes

Sipas ndarjes së pranuar klasike, njihen: mospërfillja fizike, emocionale dhe arsimore. Por ka edhe forma të tjera të cilat e identifikojnë mospërfilljen në kohërat më të reja, dhe disa prej tyre janë: mospërfillja e shkaktuar nga ana e mjedisit, mënyra e jetës etj.

Mospërfillja fizike ka të bëjë me moskënaqjen e nevojave themelore biologjike të fëmijës, siç janë: siguria, higjiena, ushqimi, kujdesi, mbrojtja shëndetësore dhe shtëpi shembullore.

Mospërfillja emocionale ka të bëjë me mungesën e mbështetjes, stimulimit të ngrohtësisë tek raportet. Qëndrim pasiv ose agresiv ndaj nevojave emocionale të fëmijës.

Mospërfillja arsimore parasëgjithash paraqet mospërfshirjen e fëmisë në procesin e rregullt arsimor, mungesë mbështetjeje dhe ndihme gjatë prvetësimit të programeve të parapara arsimore, mungesë të materialeve themelore për mësim.

Mospërfillja e shkaktuar nga mjedisi i jashtëm karakterizohet me jetesë në mjedise kriminale, varfëri, mjedis i pasigurtë.

***Format e reja të mospërfilljes janë:** ekspozim në duhanpirje pasive, mospërdorimi i ripave të sigurisë gjatë bartjes së fëmijës me automjet, si edhe përdorimit të ulëseve të duhura varësisht nga mosha e fëmijës, qasje deri tek armët, ekspozim gjatë dhunës në familje, ekspozim në dhunën në internet, mospërdorimi i helmetave gjatë ngasjes së biçikletës etj.*

1.1.3 Pasojat nga mospërfillja e fëmijëve

Mospërfillja negativisht ndikon në: zhvillimin konjitiv, social, emocional dhe fizik të fëmijës.

1.1.3.1. Ndikimi negativ mbi zhvillimin konjitiv si pasojë e mospërfilljes

Fëmijët e mospërfillur me vështirësi i zgjidhin problemet

Për shkak se këta fëmijë nuk kanë patur mundësi që të zgjidhin probleme në përputhje me moshën e tyre, përvojat e tyre të para janë negative, të pasukseshme dhe prandaj nuk kanë entuziazëm, ju mungon optimizmi jetësor dhe besimi tek aftësitë individuale. Këta fëmijë më së shpeshti abstenojnë para se të fillojnë ndonjë detyrë. Jo rrallëherë prindërit e tyre ju thonë se janë përtac, të painteresuar dhe kritikantë e tyre fëmijët i përjetojnë si vërtetim se me të vërtetë janë të paaftë për të kryer ndonjë detyrë të caktuar.

Hulumtim i lirë

Krahasuar me fëmijët tjerë të së njëjtës moshë, këta fëmijë ndijeheshin më pak të dobishëm. Me qëllim që këta fëmijë të jenë të dukshëm nga ana e prindërve të tyre nuk kanë patur mundësi që të merren me çështje tjera, që të hulumtojnë në mënyrë kurioze dhe të lirë. Shumë shpesh nuk janë në gjendje që vet të ndërtojnë, vizatojnë ose më e dukshme është kur ju ofrohet mundësia që vet të zgjedhin aktivitet, këta fëmijë nuk janë në gjendje që të vendosin se cilin aktivitet e dëshirojnë. Në periudhën e adoleshencës nuk mund të bisedojnë në mënyrë spontane, harojnë, shpesh herë kanë ndjenjën se janë të bllokuar.

Adaptimi gjatë kohës së shoqërimit me moshatarët

Këta fëmijë funksionojnë nën rregulla të caktuara dhe kufi të vendosur strikt, nuk janë në gjendje që ti shprehin aftësitë e tyre krijuese. Gjatë lojërave nuk janë përshtatës, për ata loja paraqet punë e vështirë dhe shumë investuese. Ata nuk mund të relaksohen, gjithçka duhet të parapërgatisin, planifikojnë, që ju paraqet vështirësi gjatë përshtatjes në lojë me moshatarët tjerë. Ndodhë që fëmijët të fillojnë ti shmangin, por nga ana tjetër edhe ata e bëjnë të njëjtën.

Devijime në të folurit

Këta fëmijë nuk kanë patur mundësi që në mënyrë spontane të zhvillojnë të folurit duke i dëgjuar të rriturit. Prindërit e tyre, para së gjithash e ëma nuk ju ka folur me butësi prej vet çastit të lindjes. Nga shkaku se ju mungon komunikimi me prindërit dhe mosnxitja e lirë për tu shprehur pa marrë parasysh se a e kuptojnë domethënien e fjalës, tek këta fëmijë paraqiten edhe devijime në zhvillimin e të folurit.

Zhvillimi i aftësive intelektuale

Duke marrë parasysh se këta fëmijë jetojnë në vetmi, nuk janë mjaft të stimuluar, nuk kanë mundësi që të shprehin krijimtarinë e tyre, nuk ekspozohen në situata ku duhet të zgjidhen probleme të cilat janë të përshtatshme për moshën e tyre, shpesh herë lënë përshtypje se kanë ngecje në zhvillimin intelektual ose se janë në nivel shumë më të ulët nga ajo që në të vërtetë janë.

Arritje të ulëta në shkollë

Nëse merret parasysh e lartëpërmendura, është e pritshme që këta fëmijë të kenë probleme në shkollë i cili shpie deri tek arritjet e ulëta në shkollë.

1.1.3.2. Ndikimi i mospërfilljes mbi zhvillimin social

Pasqyrë negative mbi vetveten

Si rezultat i vështërisive gjatë themelimit të marrëdhënieve me grupin e moshatarëve, problemet me të folurit, mungesë të stimulimit pozitiv dhe mbështetjes, këta fëmijë zhvillojnë pasqyrë negative për veten e tyre. Krijohet zemërim dhe tërbim ndaj të tjerëve dhe në këtë mënyrë krijojnë edhe pasqyrë negative ndaj botës.

Mungesë të ndjeshmërisë - empati

Mungesa e ngushëllimit nga ana e prindërve, nuk i ka mësuar këta fëmijë që të jenë të ndjeshëm me të tjerët dhe mjedisin. Nga ky shkak shumë shpesh ata përjetojnë si të pandjeshëm, të ftohtë, gjatë së cilës krijojnë refuzim ndaj njerëzve të tjerë.

Mungesë të aftësive sociale

Si rezultat i mospasjes ose shmangies së kontaktit me moshatarët, ata nuk janë në gjendje të zhvillojnë aftësi sociale, në këtë mënyrë ata në aspektin e përvojës janë më të varfër që rezulton me shmangien e kontaktit me të tjerët, me qëllim që të mbrohen nga përqeshjet ose refuzimet e mundshme.

Mospranim nga grupi

Njeriu është para së gjithash qenie dhe kjo në të vërtetë paraqet edhe bazën e ekzistencës njerëzore (raporti emocional zhvillohet para së gjithash në familje, ashtu që rritemi dhe zhvillohemi në grupe), mospranimi nga ana e grupit krijon ndjenjën e zemërimit. Fëmijët bëhen agresiv, si rezultat i mospranimit nga grupi të cilit dëshirojnë ti takojnë, por shpesh imponohen me forcë.

Lidhjet jokritike dhe sjellja agresive

Si rezultat i nevojës për afërsi, shpesh ndodhë që fëmijët e mospërfillur shumë herët të lidhen me njerëz të cilët mund ti keqpërdorin, është karakteristike që herët bëhen prindër, ekziton mundësia që të shfaqin sjellje të shturur. Mënyra e këtyre sjelljes paraqet vetëm tentim për tejkalimin e vetmisë ose kompensim me ndjenjën e vetmisë. Kjo mënyrë e sjelljes ndonjëherë merr formën e sjelljes së dhunshme që jo rrallëherë kalon në delikuencë.

1.1.3.3 Ndikimi negativ i mospërfilljes mbi zhvillimin emocional

Kërkesë joreale dhe jokritike për vëmendje dhe dashuri

Mu nga shkak se prej ditëve të para të jetës së tyre nuk pranojnë vëmendje që është adekuate për nevojat e tyre, këta fëmijë bëhen “të ngjitur” dhe “qasës”. Shpesh ndjeheshin të vetmuar, kanë probleme me shprehjen e emocioneve, në përgjithësi jeta e tyre nuk është e mbushur me përmbajtje të

duhur jetësore e cila do t'jua përmbushte jetën, nga ky shkak shpesh herë janë të tërhequr dhe të pavullnetshëm.

Mospasje të përgjegjësia

Përgjegjësia si edhe mënyrat për menaxhim me stresin janë diçka që nuk është zhvilluar tek këta fëmijë e më vonë edhe si të rritur, por nga ana tjetër, për shkak të mosmiratimit dhe mospranimit nga ana mjedisi këta fëmijë sërish shpeh janë nën stres. Jo rrallëherë kanë probleme gjatë kontrollit të impulseve, sepse ata mundohen me diçka që fëmijët tjerë e bëjnë me lehtësi, spontanisht dhe në mënyrë natyrore. Për shkak të zemërimeve të kohë pas kohshme shumë shpesh arrijnë deri tek konflikti me fëmijët tjerë, që edhe më shumë i largon nga ata. Njëkohësisht për shkak të dështimeve të shpeshta shumë më shpesh janë të frustruar, zemëruar dhe e shmangin mjedisin.

1.1.4 Shenjat fizike të cilat na shfaqen tek fëmijët e mospërfillur

- Shenjat,
- Dëmtim në zhvillimin e trurit si rezultata i sindromit fetal alkoholik
- Anomali të ndryshme dhe zhvillim i ngadalësuar psikomotorik
- Zhvillim i sëmundjeve kronike dhe infeksioneve respiratore
- Paraqitja e sëmundjeve infektive si rezultat i mosvaksinimit
- Mbiushqim, stomak i fryrë, dehidrim, rritje e ulët
- Nofull me dhëmbë me karies, nuk ka kujdes të duhur shëndetësor
- Shpesh është i uritur, rraskapitur, i lodhur
- Veshmbathja është e fëlliqur, e ngrisor, e papërshtatshme për kushtet klimatike

Shenjat dhe sjelljet e të rriturit i cili e mospërfill fëmijën

- Bën jetë kaotike, nuk kujdeset për nevojat personale
- Kohë të gjatë nuk e mbikëqyr fëmijën edhe atëherë kur është i ekspozuar në rrezik
- E lë fëmijën nën kujdesin e personave të papërshtatshëm
- I jep ushqim, ilaçe dhe pije të papërshtatshme
- Vazhdimisht e çon fëmijën shumë herët në shkollë ose kopsht, ndërsa e merr shumë vonë
- Nuk shfaq interesim mbi nevojat e fëmijës
- Vazhdimisht është i painteresuar dhe i pakapshëm për komunikim, kur bëhet fjalë për fëmijën (nuk merret në telefon, i shmang mbledhjet prindërore ose mbledhjet e caktuara)
- E eksploaton fëmijën dhe ekspozon në punë të vazhdueshme dhe të rrezikshme
- Apatik dhe indiferent

Mospërfillja afatgjate, në veçanti në moshën shunë të hershme mund të shpie deri në vdekje të fëmijës. Dihet se fëmijët vdesin edhe si rezultat i stresit tak vaji i fuqishëm dhe i pandërprerë. Për fat të keq, mospërfillja shpesh nuk identifikohet herët që të mund të parandalohet, identifikohet në fazat e fundit kur ekspozohet në mënyrë ekstreme. Nga shkakun se ka shumë fëmijë të cilët janë të mospërfillur në mënyrë implicite, edukimi i prindërve, edukatorëve, kujdestarëve dhe mësimeve të tjerë si edhe përpilimi i programeve speciale paraqesin aspekt të rëndësishëm për parandalim.

1.2 Dhuna emocionale mbi fëmijët

Kur bëhet fjalë për dhunën emocionale mbi fëmijët, karakteristikë e këtij lloji të keqpërdorimit është se shumë vështirë dëshmohet, shihet dhe

parandalohet. Numri i madh i prindërve ose të rriturve janë të vetëdëshëm se dhuna, në veçanti ajo trupore është e palejueshme, papranueshme. Por, gjithsesi ekzistojnë prindër/kujdestarë dhe të rritur të tjerë të cilët janë të rëndësishëm në jetën e fëmijës, e shfrytëzojnë dhunën emocionale si një formë për dënim dhe dëshim të fuqisë së tyre para fëmijës. Pas dyerve të mbyllura, fëmijët ballafaqohen me fjalë fyese, kërcënime, ushtrim të frikës dhe kritikave joreale. Ata nuk e dinë se si ti përgjigjen kësaj forme të dhunës, ndjehen keq, por ju besojnë prindërve të tyre, e me të edhe secilës fjalë dhe kritikë që del nga goja e prindërve. Fëmijët besojnë se janë të atillë, ashtu siç prindërit e tyre i emërtojnë dhe perceptojnë.

Këta fëmijë, dukshëm janë të rregulluar, të mirëmbajtur, nuk vërehen tregues trupor të cilët do të na shfaqnin keqpërdorim, por bëhet fjalë për fëmijë të pikëlluar të cilët nuk e dinë se çfarë në të vërtetë prindërit kërkojnë prej tyre. Ata janë të frikësuar, apatik, pa ndjenjë përkatësie, dashurie dhe vlere. Nuk ndjehen të veçantë, të aftë dhe të vlefshëm.

1.2.1 Treguesit të cilët e shfaqin keqpërdorimin emocional

Sjellja e fëmijës tek i cili ekziston dyshimi se është bërë keqpërdorimi emocional

- Paraqitet i dëgjueshëm dhe i turpshëm
- Ka çaste agresiviteti dhe tërbimi
- Posedon frikë nga dështimi
- Ka probleme me koncentrimin dhe mësimin
- Lehtë heqë dorë
- Ka qëndrim negativ mbi veten
- Qan vazhdimisht, kërkon falje pa ndonjë arsye të veçantë
- Vazhdimisht kërkon vëmendjen e të rriturve

Sjellja e të rriturve të cilët ndoshta ushtrojnë keqpërdorim emocional ndaj fëmijës

- A akuzon ose nënçmon fëmijan publikisht ose në shtëpi
- Nuk e qetëson fëmijan kur është i krikësuar ose i shqetësuar
- Nëse ka më shumë fëmijë në familje, fëmijët tjerë i trajton në mënyrë tjetër (pa kritika dhe fyerje)
- Ushtron fjalë fyese gjatë prezantimit të fëmisë (injorant, i keq, i paaftë etj)
- E akuzon fëmijan për të gjitha mospjekurat e tij
- E krahason dhe barazon fëmijan me fëmijët tjerë, persona të cilët nuk i do

2. Stilet prindërore

Sipas Z. Milivojeviq dhe bashkëpunëtorëve 2009 “Libër i vogël për prindër të mëdhenj “(faqe 85) theksohen disa stile nga të cilat dallohen prindërit në mënyrën e edukimit të fëmijëve:

Sipas autorëve, kur bëhet fjalë për edukimin e fëmijëve, ata dallojnë pesë stile edukative:

Stil i tepruar edukativo-socializues ose sindromi i fëmijës me socializim të tepruar

Prindërit me karakteristikat e këtij stili edukativ, shumë shpesh kanë kërkesa shumë të larta ndaj fëmijëve të vet. Kur sukseti i fëmijëve është spektakular ata pranojnë vërtetim për suksesin e tyre . Mu për këtë shkak këta fëmijë vazhdimisht përpiqen që ti kënaqin të tjerët e në veçnati prindërve të tyre. Ata nuk janë të kënaqur me veten e tyre, me arritjet , aftësitë dhe dukjen

e vet. Ndonjëherë kanë mendime se do të ishte shumë më mirë sikur të mos lindnin fare. Fëmijët të cilët janë edukuar në këtë stil mendojnë se vetëm modestia është vrytyt, vetëbesimi është diçka që është karakteristike për njerëzit e pandërgjegjshëm. Ata nuk janë në gjendje të përjetojnë kënaqësi nga suksesi i tyre dhe me vetëbesim të kërkojnë vërtetim për të njëjtën. Modestia është karakteristikë e mirë por kur bëhet dominante dhe tepër e theksuar i ngulfat personalitetet, potencialet dhe arritjet.

1. Stili i edukimit të lazruar ose sindromi i fëmijës së lazruar

Ky stil edukimi është karakteristik për prindërit të cilët gjatë zhvillimit të tyre kanë qenë të edukuar në mënyrë të rreptë. Këta prindër janë betuar se fëmija i tyre do të jetë i lumtur, se nuk do të edukohet ashtu siç e kanë edukuar prindërit e tyre. Prandaj gjatë rritjes, ata nuk e kanë kufizuar fëmijan e tyre, rrallë herë e kanë përdorur fjalën JO. Këta fëmijë janë kritikuar nga prindërit e tyre vetëm në rast kur kanë qenë të pafuqishëm dhe asnjëherë nuk kanë qenë të dënuar në mënyrë të duhur për ndonjë sjellje të caktuar. Bëhet fjalë për prindër të cilët kanë probleme për të shfaqur fuqinë e tyre prindërore. Ata kanë kërkesa, por rrallë herë kanë kërkesa aktive për fëmijën e tyre. Këta fëmijë kanë mendim të mirë për veten e tyre, ndjehen komod sepse gjithçka është rregulluar sipas mevojave të tyre. Por, nëse ju caktohen detyra dhe përkufizime, këta fëmijë bëhen impulsiv. Kanë vërejtje nga mjedisi se nuk janë mjaft të durueshëm dhe se tepër i lejojnë vetes, mendojnë se për ata nuk ka drejtësi, kritikën mbi sjelljen e tyre i identifikojnë si kritikë ndaj personalitetit të vet. Këtyre fëmijëve si edhe gjithë të tjerëve ju nevojiten përkufizime të caktuara, ju duhet dashuri e parezervë, butësi dhe kujdes por nga ana tjetër edhe dashuri e rreptë. Shpeshë herë i lazdrojmë fëmijët pa vetëdije për shkak të ndjenjës së keqardhjes, sepse jemi tepër të zënë dhe kemi pak kohë që të jemi me fëmijët tanë. Keqardhja mund të na çojë në shmangje të konfliktit me fëmijan dhe jemi në rrugë të drejtë që të

lazdrojmë atë. Nuk duhet të harojmë se sa më vonë që ti bëjmë përkufizimet mbi sjelljen aq më vështirë do të jetë për fëmijan që ti pranojë ato. Duhet të edukojmë me shumë dashuri dhe me detyrime dhe kërkesa reale në drejtim të më së mirës për fëmijët tanë.

2. Stili edukativ mbi-mbrojtës ose sindormi i fëmijës të mbi-mbrojtur

Karakteristikë e këtyre fëmijëve është se ata janë shumë të qetë dhe të urtë. Edhe pse janë të shëndetshëm, shumë vonë fillojnë të ecin, të flasin, vonë i heqin edhe pelenat. Këta fëmijë janë tepër të kujdesshëm, nuk hypin në luhatëse, rëshqitëse etj. Karakteristikë e tyre është se janë shumë të mvarur, nëse ndonjë, që për ata paraqet siguri nuk është aty, nuk e shohin rreth veti duket të frikësuar dhe të pasigurtë. Prindërit e këtyre fëmijëve shpesh herë mendojnë se detyra e tyre prindërore është që ti mbrojnë fëmijët e tyre nga secili lloj i rrezikut, për këtë qëllim, dashurinë e tyre e shprehin në formë të një kujdesi të tepruar. Kjo mënyrë e edukimit nuk ju lejon fëmijëve që të mësojnë se janë të aftë që vet të kujdeset për veten e tyre, nuk ju lejon që të hulumtojnë për të zhvilluar shkathtësi sociale për grupin e tyre të moshatarëve. Këta fëmijë frikësohen nga bota. “Dëmin” më të madh që mund ta shkaktojnë prindërit e mbi-mbrojtje ndaj fëmijëve të tyre është që t’ju ndalojnë të jenë të aftë, ku fëmija beson se ai më është i paaftë, nuk angazhohet dhe kalon në pasivitet. Nga shkak se ky fëmijë nuk ka patur mundësi që ti zhvillojë aftësitë e veta me ndihmën e përvojës jetësore, nuk ka mendim të lartë për vetën e tyre dhe nuk beson në aftësitë e veta.

Dallimi me fëmijës së lazduar dhe atij të mbi-mbrojtur është i dukshëm kur bëhet fjalë për lloje të pastërta, ku fëmija i mbi-mbrojtur është i frikësuar dhe i paaftë, ndërsa i lazduari është dominat dhe i fuqishëm. Prindërit mbi-mbrojtës janë të fuqishëm, ndërsa prindëri i cili lazdron është i pafuqishëm

Stili edukativ mospërfillës ose sindromi i fëmijës së mospërfillur

Këta prindër nuk kanë fare kërkesa ndaj fëmijëve të tyre, nuk i lavdërojnë dhe nuk i shpërblejnë. Prindërit e këtyre fëmijëve kishin kërkesa që të ndryshojnë sjelljen e papranueshme, por nuk ju thonë fëmijëve se si duhet të bëjnë të njëjtën. Në stilin edukativ të këtyre prindërve nuk ka kritika reale, ata kritikojnë vetëm kur ndonjë sjellje e caktuar e fëmijëve të tyre ju “vjen n’maje të hundës”. Këta prindër fëmijan e tyre nuk e përfillin dhe në aspektin edukativ e kanë lënë pas dore. Gjatë rritjes këtyre fëmijëve ju mungon dashuria, por edhe nxitja edukative. Këta prindër shumë pak bisedojnë me fëmijët e tyre, nuk ju tregojnë se çka është e drejtë e çfarë nuk është. Këta prindër nuk ju ndihmojnë fëmijëve të tyre që të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë në familje. Në pjesën më të madhe të kohës të cilën e kalon fëmija me familjen e vet është i lënë vet. Prindërit duhet të kuptojnë se fëmijët nuk mund të edukohen vetvetiu, ata i edukojnë prindërit. Njëkohësisht, edukimi është një proces aktiv, ku fëmija nuk mund të mësojë dhe të udhëzohet nëse na shikon në mënyrë pasive se si ne reagojmë në ndonjë situatë të caktuar. Nëse fëmijës nuk i mundësojmë dashuri, ndjenjë përkatësie, ky fëmijë do të ketë ndjenjën se nuk është i vlefshëm si fëmijët tjerë dhe secilën ndjenjë përkatësie do të përpiqet ta ndërprejë që të mund të arrijë kënaqësi. Kur do ta lavdërojnë do të hutohet edhe pse kjo është shumë me rëndësi për të, do të përpiqet në çdo mënyrë të jetë pranuar nga mjedisi, të pranojë kujdesin e nevojshëm qoftë edhe një kritikë.

Stili abuziv edukativ ose sindromi i fëmijës së abuzuar

Për këta fëmijë është karakteristike që kur lëvizin ata në mënyrë dominante e shprehin forcën e tyre fizike. Kanë shprehje agresive të fytyrës, kohë pas kohe grushtojnë nëpër mure ose me ndonjë kundërshtarë të imagjinuar. Prindërit e këtyre fëmijëve mendojnë se dënimi trupor është mënyra e mirë dhe e vetme e edukimit. Njëkohësisht edhe këta prindër kanë qenë të edukuar në të njëjtën mënyrë, gjatë fëmijërisë së tyre vazhdimisht janë përpjekur që të mos gabojnë diçka që të mos rihen. Tek këto familje, e ëma mendon se fëmija nuk duhet rahur, por kur nuk është në shtëpi i ati i cili është dhunuesi “kryesor”, e ëma shfrytëzon mënyra të tjera të dënimit dhe vazhdimisht i kërcënohet duke përdorur fjalë fyese dhe kërcënime. Këtij fëmija të rahur shumë shpesh, prindërit nuk i japin kërkesa të qarta dhe nuk i tregojnë se çfarë në të vërtetë kërkohet prej tij, njëkohësisht nuk i tregohet se çfarë ka gabuar. Nëse e pyetni këtë fëmijë se cila ka qenë arsyeja e rahjes së fundit, nuk di që të tregojë. Por nëse i pyesim prindërit pse nuk e lavdërojnë fëmijan e vet, kur do të veprojnë diçka të shkëlqyeshme, ata do të përgjigjen se do ta lavdërojnë vetëm kur të ndryshojë sjelljen e vet. Në shikim të parë ky fëmijë duket se ka mendim të mirë për veten, por pjesa e jashtme nuk përputhet me ndjenjat e vërteta të këtij fëmija. Për shkak të mesazheve që i pranon nga prindërit e vet, ky fëmijë ndjehet i pafuqishëm, i pavlefshëm për dashuri dhe kujdes nga të tjerët, askujt nuk i beson dhe jeton në frikë të përhershme se dikush mund ta godisë. Ky fëmijë pdo prekje e kupton si abuzim trupor. Pamja dominante është vetëm një paskë me qëllim që dikush mos ti afrohet dhe të mos e sulmojë. Ky fëmijë ka probleme në procesin e mëvetësimit dhe funksionimit në mjedisin social. Fëmijët të cilët përjetojnë abuzime trupore identifikohen me agresorin, me atë i cili e abuzon dhe në këtë mënyrë do të përpiqet dhe do të bëhet i njëjtë si edhe agresori. Këta fëmijë marrin vendim se asnjëherë më nuk do të jetojnë me dhunën, dhe kur një ditë do të rriten do ti kundërvihet babait të vet ose dikujt tjetër i cili i ka shkaktuar dhunë trupore. Por, nga ana tjetër këta fëmijë konkludojnë se janë të pafuqishëm dhe janë të përcaktuar për çdoherë të jenë viktima. Nga ky shkak

ata mund të jenë të tërhequr, me frikë kronike me qëllim që të mos provokojnë që dikush ti sulmojë apo lëndojë. Këta fëmijë e përjashtojnë nga sjellja e tyre çdo mundësi që ata të provokojnë dhunë.

3. Dënimi dhe shpërblimi gjatë procesit edukativ

3.1 Llojet e mësimit tek fëmijët

Me qëllim që të kuptojmë mënyrën se si funksionon dënimi si metodë, para së gjithash duhet të kemi dije mbi mënyrën se si fëmija gjatë jetës mëson dhe përvetëson dije. Kur bëhet fjalë për mësimin tek foshnja-fëmija, para së gjithash janë të udhëhequr nga fakti se zhvillimi i hershëm fëmijëror është periudha më e rëndësishme e jetës së njeriut, duhet të kemi parasysh se ekzistojnë disa lloje të mësimit në fëmijërinë e hershme.

Kushtëzimi klasik

Paraqet lidhje të nxitjes së re me një nxitje të pakushtëzueshme ose të pamësuar e cila automatikisht sfidon përgjigje të pakushtëzueshme. Mësimi me kushtëzim klasik fillon në periudhën paranatale. Ky lloj i mësimit ka ndikim të veçantë mbi zhvillimin e reagimeve emocionale. Për shembull, nëse ndjehemi jokomod me disa njerëz që janë në praninë tonë, dhe të njëjtit njerëz i lidhim me atë se sikur ata janë të pakëndshëm e njëjta ndodh edhe me reagimet pozitive.

Kushtëzimi instrumental/kushtëzimi operacional

Me këtë lloj të mësimit arrihet një sjellje si rezultat i pasojave nga sjellja. Tek ky lloj i mësimit bëhet fjalë për mbështetje pozitive apo negative. Mbështetjet në të vërtetë janë stimulime të cilat paraqiten si rezultat i sjellje dhe efektit nga përsëritja e sjelljes.

Mbështetja pozitive

Ka të bëjë me stimulimet pozitive (buzëqeshja, ledhatimi, përqaftimi, lodra e preferuar). Nga shkak se një veprim i caktuar është i mbështetur me stimulimet pozitive, ka tendencë që e njëjta të përsëritet.

Mbështetja negative

Ky lloj mbështetjesh paraqitet që të mënjanohet ndonjë stimulim i padëshiruar. Paraqitet kur ka tendencë që të mënjanohet ndonjë situatë e padëshiruar e cila është shkaktuar nga ndonjë sjellje. Kur fëmija dëshiron që ti bleni ndonjë lodër ai qanë, nëse ja bleni ai sërish radhën tjetër do të përsërisë sjelljen e vet me qëllim që të zvogëlojë frustrimin e vet dhe të përfitojë kënaqësi.

3.2 Dënimi

Dënimi është proces i cili zbatohet tek stimulimi i pakëndshëm pasi të bëhet ndonjë aktivitet me qëllim që të zvogëlohet shpeshësia e paraqitjes së sjelljes së pakëndshme negative. Për shembull, fëmija dënohet sepse e ka goditur shokun e vet dhe si dënim nuk lejohet të delë jashtë. Si përgjigje nga dënimi pritet që të mos përsëritet sjellja.

Dallimi mes mbështetjes negative dhe dënimit është se gjatë mbështetjes negative, stimulimit negativ paraqitet paraveprimi, ndërsa gjatë dënimit e njëjta paraqitet njëherë për sjellje.

Efikasiteti është më i madh kur bëhet fjalë për vendosjen e kufinjëve të qartë dhe disiplinimin e fëmijëve gjatë mësimit me mbështetje se sa me dënim. Mbështetja ekziston që të mbahet një sjellje ndërsa dënimi që të mënjanohet e njëjta, në të cilën zvogëlohet intensiteti i disa sjelljeve për shkak të mungesës së mbështetjes. Për shembull, nëse fëmijës nuk ja blejmë lodrën kur ai qan fuqishëm në dyqan do të kuptojë se vaji nuk është metod efiakas për të përfituar atë që dëshiron dhe me kalimin e kohës do ta shfrytëzojë atë shumë më pak.

Mësimi observues është lloj i mësimit me të cilin paraqitet ndryshimi tek veprimi i një sjelljeje të caktuar tek fëmijët si rezultat i vështrimit të tjerëve se si ata realizojnë veprime apo aktivitete të caktuara. Me imitimimin e modeleve të gjalla, ose me shfrytëzimin e lojërave të ndryshme, lodrave, fëmija mëson se si të dnyshojë sjelljen e tij.

3.3 Shpërblimi

Shpërblimi është konkret, dhe për një shpërblim të vërtetë flasim atëherë kur pranojmë ndonjë të mirë materiale ose ndonjë komoditet. Kur e shpërblejmë fëmijan zgjedhim se çfarë është r rëndësishme për të dhe çfarë ai dëshiron.

Shpërblimi material

Kur bëhet fjalë për këtë shpërblim, në të vërtetë është diçka që është e dukshme dhe e prekshme. Fëmijan e shpërblejmë për ndonjë veprim të caktuar ose grumbull sjelljes të cilat kanë çuar deri tek rezultati konkret.

Për shembull, nëse Marko pesë netë me radhë fle në dhomën e tij, shpërblimi do të jetë një raketë të cilën për kohë të gjatë e dëshiron.

Gjithashtu, me shpërblim material shpërblehet edhe ndonjë veprim i caktuar i cili shfaq një përparim të madh të fëmijës.

Psh., fëmija viziton dentistin, çdoherë në shoqërim të prindërve të cilët janë me të. Por, ata e nxisin dhe i thonë se është i guximshëm dhe i mirë , vetëm e vetëm që të ulet në ordinancë përderisa ti kontrollohen dhëmbët. Për këtë i premtojnë lodër të re.

Komoditet

Komoditeti është privilegj, diçka që fëmija e dëshiron, një nevojë themelore e cila duhet plotësuar. Psh., ndjekja e filamve të animuar, piknik, pushim, një shfaqje në kinema etj.

Kur të premtojmë shpërblimin

Në rast kur dëhirojmë të nxisim ndonjë sjellje të re tek fëmija. Mund ta shfrytëzojmë si metodë me qëllim që të parandalojmë lutjen e fëmijës nëpër dyqane për ti ble ndonjë gjësend për të cilin mendojmë se ka nevojë. Por, kur bëhet fjalë për fëmijë të vegjël, të cilët mendojnë se gjithçka që sheh duhet për momentin ta merr shpërblimin nuk është funksional, por për fëmijët pak më të rritur ja vlenë që të shfrytëzohet ndonjëherë.

Duhet të jemi të vetëdishëm se nëse fëmijës i kemi premtuar ndonjë shpërblim dhe ai është sjellur në përputhje me marrëveshjen atëherë i njëjti duhet plotësuar. Nëse prindërit e tradhtojnë fëmijan atëherë me të vërtetë është një përvojë traumatike për fëmijan dhe e lëkund marrëdhënien ndaj prindërve.

Shpërblimi nuk duhet të përdoret shumë shpesh dhe të okupojmë fëmijan me shpërblime të ndryshme edhe atë për çdo imtësi. Numri i shpërblimeve varet edhe nga mosha e fëmijës, psh., fëmijan e vogël mund ta shpërblejmë për arritja më të vogla, ndërsa adoleshentin e shpërblejmë kur një kohë të gjatë ka investuar punë , mund hde kohë për përmbushjen e ndonjë qëllimi të caktuar.

Nëse shpërblimet janë të shpeshta dhe fëmija i merr me lehtësi, atëherë ekziston inflacion i shpërblimeve, gjegjësisht, kur shpërblimi nuk paraqet më asnjë akt, sepse fëmija nuk duhet të përpiqet aq shumë për të fituar shpërblimin. Ndonjëherë si prindër jemi të lumtur edhe kur fëmija vetëm premtan se do të plotësojë ndonjë detyrë të dhënë dhe atëherë menjëherë e shpërblejmë, por duhet të jemi të vetëdijshëm se duhet të presim që ai të plotësojë premtimet dhe detyrimet e tij dhe pastaj ta shpërblejmë ashtu siç jemi dakorduar.

Çka është loja dhe si të luhet?

Shikuar historikisht, loja fëmijërore paraqitet njëkohësisht me nevojat nga edukimi i veçantë i fëmijëve dhe mu për këtë shkak mund të thuhet se prej fillimi loja dhe edukimi paraqiten bashkarisht dhe janë të lidhura ndërveti dhe kushtëzohen në mënyrë të ndërsjellë (Shkariq,2004).

Si motiv i fëmijëve për lojë tek periduha parashkollore mund të paraqiten dëshira të papjekura të cilat nuk mund të plotësohen menjëherë, e njëkohësisht nuk ka paraqitje të lojës tek fëmijët përderisa i kënaqen të gjitha nevojat.

Sipas Shkariqit 2004, loja mund të shqyrtohet si një strukturë objektive e cila paraqitet në formë të sistemit të rregullave. Ky sistem i rregullave i ofron lojtarit skemë për sjellje personale kur luan ndonjë lojë.

Secila lojë ka strukturë hapësinore dhe kohore, por gjithashtu përbëhet edhe nga elemente të organizuara. Por më mirë është të flitet për lojë, që paraqet aktin e atij që luan, se sa për lojën e cila është e kuptuar si strukturë e cila është paraprakisht e përcaktuar.

Si luhet?

Së pari fëmijëve duhet dhënë kohë të mjaftueshme për lojë. Por loja nënkupton:

1. Hapësirë të përshtatshme

Fëmijët duhet të luajnë në një hapësirë të sigurtë, pa kufizime, të pastër dhe ashtu siç mendojnë ata se duhet të jetë në përputhje me lojën e tyre.

2. Lodra dhe mjete të përshtatshme për lojë

Janë të nevojshme materiale cilësore dhe lodra adekuate që fëmijët të mund të luajnë dhe njëkohësisht të edukohen. Cilësia e lodrave është një faktor i rëndësishëm, e jo faktori kuantitativ i cili ndikon në cilësinë e lojës. Nëse fëmija ka shumë lodra nuk do të mund të zgjedhë lojën e tij të përshtatshme.

3. Gjatë lojës i nevojshëm është bashkëlojtari

Që të mund të paraqiten aktivitete paraluajtëse ka nevojë që prindërit të jenë të përfshirë në mënyrë aktive edhe gjatë procesit të lojës. Fëmijët e një moshe të caktuar më shumë dëshirojnë të luajnë njëri prskaj tjetirt se sa të keni interaksion mes veti, psh., në moshën tre vjeçare, të ashtuquajtura loja paralele. Ashtu siç rriten fëmijët dëshirojnë të luajnë me fëmijët tjerë në grupe më të vogla. Ashtu siç rritet numri i grupeve rritet edhe nevoja për lojëra për të cilat ka nevojë të ketë rregulla, bashkëpunim dhe ndarje të roleve.

Loja është mënyrë përmes së cilës fëmija mund ti tejkalojë frikën, dyshimin dhe nevojën e vet. Prindëri përmes lojës e cila njëkohësisht ka edhe karakter terapeutik është në mundësi që të mbikëqyrë zhvillimin e fëmijës të vet, të parandalojë dhe të udhëzojë.

Të luajturit me fëmijët tuaj do t'ju lë atyre kujtime të bukura që atyre do u mëndësojnë kujtime plotësuese të bukura!]

Veprimet e prindit të përgjegjshëm në edukim

Përcakton kufinj të qartë

Prindëri i përgjegjshëm përcakton kufinjë lidhur me sjelljen e fëmijës të vet, i diskuton me të me një gjuhë të qartë për fëmijan. Gjithashtu ja sqaron pasojat nga ndonjë sjellje.

Kujdeset për shëndetin e fëmijës, është pranuar ndarja klasike në kuptimin më të gjërë të fjalës.

Mban llogari për shëndetin e fëmijës të vet.

Kjo nënkupton shëndet fizik dhe mental. E çon në kontrollime të rregullta mjekësore, por gjithashtu kujdeset edhe për zhvillimin e tij mental.

Prezent në mënyrë aktive

Pa marrë parasysh se sa është i zënë, një pjesë të kohës e kalon në bisedë me fëmijan e vet, i respekton nevojat e tij, ja ofron kujdesin e nevojshëm, i shpreh dashuri dhe e përqafo.

Kujdeset për arsimimin e fëmijës

Përskaj përpjekjes për ti siguruar arsim cilësor, ai kujdeset edhe për sistemin e vlerave të fëmijës.

E mëson fëmijën e vet të pavarësohet

Prindi i përgjegjshëm e mëson fëmijan e vet në shkathtësi të ndryshme dhe e inkurajon fëmijan që të jetë i përgjegjshëm për të njëjtat.

E mëson fëmijën e vet që të pranojë dështimin

Është shumë me rëndësi që fëmijët të mësojnë të pranojnë dështimin, nuk e krahason fëmijan me fëmijët tjerë, por e nxit atë dhe e mbështet.

Përfundim

Qëllimi i këtij udhërrëfyese të shkurtër është që të nxisë prindër të përgjegjshëm, të fitohen informata në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve në relacion prindër- fëmijë.

Nëse e identifikoni veten në ndonjë nga veprimet e përshkuara në mënyrën e edukimit, mos u ndjeni me faj. Secili mund të bëhet prind i mirë dhe kemi mundësi që të ndryshojmë sjelljen tuaj. Prandaj filloni të bëni atë që deri më tani nuk e keni bërë, nëse nuk jeni të sigurtë se a veproni drejtë, mendoni se a dëshironi që dikush të veprojë në mënyrë të njëjtë.

Dëshirojmë t'ju nxisim që pozitivisht të mendoni, të jeni të sigurtë se keni zgjedhje, të qenit prind është proces i cili mësohet. Duani fëmijët tuaj rezervë, disiplinoni ato me shumë dashuri dhe do t'ju jenë faleminderues.

Ose, sië thotë i madhi Ljubovoje Rashumoviq në këngën e tij

„Fëmija nuk është fëmijë,
Lojë për halla e teze,
Fëmija është fëmijë,
Që ta dashuroni dhe kuptoni .“

TË GJITHË MUND TË JEMI PRINDËR TË MIRË!

7. Literatura

1. „Libri i vogël për prindër të mëdhenj“, 2009(Z.Milivoeviq, K.Billban, V.Kokel, M.Kramberger, T. Steiner, B. Kozhuh)
2. Psikologjia zhvillimore, 2004, (O. Murxheva Shkariq)
3. Psikologjia e fëmijërisë dhe adoleshencës,2011 (O. Murxheva Shkariq)
4. Unë jam OK ti je OK, (E. Bern)
5. Cilën lojë e luan (E. Bern)
6. Protokoli i përbashkët për veprim në rast të abuzimit dhe mospërfilljes së fëmijëve, 2014 Qeveria e Republikës së Maqedonisë
7. Edukimi i fëmijëve, Sillson 2001 (I.Kant)